



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1672/ 7 prot.

Datë 15.07.2025

V E N D I M

Nr. 904 / 2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.07.2025 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klodjan Vërçani” P.F në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me objekt: Botime, printime dhe materiale shtypshkrime ndarë në 2 (dy) lote,

Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeritar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Loti 2. Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Rajonal Elbasan, me Nr. REF-49293-05-28-2025, me fond limit 3,190,580 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “RAMA GRAF” ShPK, me Nipt K42701205E, Adresa: Rr. Dhimitër Xhuvani, Z. Kadastrale nr. 8521, Nr. Pasurie 4/7, kati 1, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
Adresa: Rr. Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Klodjan Vërçani” P.F, me Nipt L81325026K, Adresa: Nj. Bashkiake nr.9, Rr. "Rreli", Nr.20, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.05.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me objekt: Botime, printime dhe materiale shtypshkrime ndarë në 2 (dy) lote,

Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeristar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 09.06.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi **Loti 1** “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeristar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 18.06.2025, autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi renditjen e pjesëmarrësve me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. RAMA GRAF ShPK	me ofertë	2,464,300	lekë	Skualifikuar
2. Inpress ShPK	“	2,716,800	“	Kualifikuar
3. Filara ShPK	“	2,820,000	“	Kualifikuar
4. Kristalina.KH ShPK	“	2,875,300	“	Kualifikuar
5. Adel Co” Shpk	“	2,883,600	“	Kualifikuar
6. Klodian Vërçani P.F	“	3,144,180	“	Kualifikuar
7. Marketing & Distribution ShPK	“	4,278,400	“	Kualifikuar
8. ALBDESIGN PSP	“	0	“	Skualifikuar

II.3. Autoriteti Kontraktor më datë 19.06.2024, ka publikuar në SPE Njoftim Fituesi Paraparak.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5477, datë 25.06.2025 dhe me Nr. 1672/2025 Prot., date 26.06.2025 si edhe ankesa me nr. A/2025/5479, datë 25.06.2025 dhe me Nr. 1672/1/2025 Prot., date 26.06.2025, e operatorit ekonomik “RAMA GRAF”ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me objekt: me objekt: Botime, printime dhe materiale shtypshkrime ndarë në 2 (dy) lote,

Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeristar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Loti 2. Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Rajonal Elbasan, me Nr. REF-49293-05-28-2025, me fond limit 3,190,580 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Klodjan Vërçani” P.F, në procedurën sipërcituar.

II.4.1. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formulari për publikim Nr. 1672/2 Prot., datë 27.06.2025.

II.5. Në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka mbërritur shkresa protokolluar me nr. 1672/3, datë 01.07.2025, Formular i Paraqitjes së Argumenteve, nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK, me anë të së cilës kundërshton pretendimet e ankimuesit si vijon: *[...Së pari ankesa është paraqitur jashtë afatit 7 ditor nga data e njoftimit të fituesit 19.06.2025 Së dyti ankesa është e pakuptimtë dhe e papranueshme e cila duhet të refuzohet pasi OE Rama Graf ShPK nuk ka kundërshtuar skualifikimi e tij, pasi është vetë i skualifikuar për ofertë anomalisht të ulët dhe ska interes të ligjshëm.*

Kërkojmë lënien të skualifikuar të ankimuesit dhe vlerësimin të rregullt dhe të vlefshëm të ofertës ekonomike të paraqitur nga OE Inpress ShPK.

II.6. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 1654/16 me datë 03.07.2025, protokolluar me tonën me Nr. 1672/4, datë 04.07.2025 me objekt Vendim Nr.62/2025, datë 02.07.2025, i KSHA-së, me anë të së cilit ka vendosur Mospranim të Ankesës së operatorit ekonomik “RAMA GRAF” ShPK. Në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...]Nga shqyrtimi i ankesës së OE “RAMA GRAF” ShPK, KSHA konstaton se OE është skualifikuar për ofertë anomalisht të ulët në bazë të nenit 82/ të VKM Nr. 285/2021.

OE në ankesë nuk parashton asnjë pretendim mbi skualifikimin e tij dhe nuk ka prespektive reale për të fituar kontratën, cka impakton interesin e tij të ligjshëm për vijimin e kësaj ankesë pasi edhe nëse do të skualifikohej Klodjan Velcani P.F oferta e tij do të rezultonte anomalisht e ulët. Për sa më sipër KSHA vendos:

Refuzimin e ankesës.

Personi përgjegjës të njoftojë ankimuesin, operatorët ekonomikë të interesuar dhe KPP-në. për marrjen e këtij vendimi.[...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit "RAMA GRAF" ShPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "Klodjan Vërçani" P.F me pretendime si më poshtë vijon:

"Kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit në të dyja lotet dhe ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Referuar procedurës së sipercituar në të dyja lotet ka marrë pjesë edhe operatori ekonomik Klodjan Vërçani P.F cili është kualifikuar në të dyja lotet nga autoriteti kontraktor.

Kundershtojme kualifikimin e operatorit ekonomik pjesëmarrës "Klodjan Vërçani" P.F në dy lotet...

Pas një kërkesë për sqarim drejtuar AK-së , që nese nje OE është pjesëmarrës në dy lote dhe mund të rezultojnë fitues në të dy lotet plotësimi i kriterëve të Vecanta për Kualifikim në këte rast do të jete shuma e kriterëve të Lotit 1 dhe të Lotit 2, pasi vetëm në këte mënyrë mund të vërtetojmë që nje OE zoteron kapacitet e teknike dhe finaciare të mjaftueshme për përmbushjen e të dy loteve?

Ne keto Kushte kërkojmë Sqarime të lidhje me pikat sipercituara..."

AK po në SPE ka kthyer përgjigje si më poshtë vijon:

"Në përgjigje të kërkesës suaj për sqarim ju bëjmë me dije se: Referuar pikës 3 të nenit 64 të VKM-së Nr 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku shprehimisht thuhet se: Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Megjithatë këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Kjo lloji marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues për marrëveshja kuadër me disa operatorë ekonomikë i referohet procedurës së prokurimit në tërësi ku për çdo lot do të ketë një një operator ekonomik fitues.

Përsa më sipër Marrëveshja Kuadër do të lidhet me një operator ekonomik dhe nuk do të ketë rihapje të konkurrimit, por do të bazohet në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Lidhur me kërkesën tuaj për sqarim nese nje operator ekonomike është pjesëmarrës në dy lote dhe mund të rezultojnë fitues në të dy lotet plotësimi i kriterëve të Vecanta për Kualifikim në këte rast do të jete shuma e kriterëve të Lotit 1 dhe të Lotit 2, pasi vetëm në këte mënyrë mund të vërtetojmë që nje OE zoteron kapacitet e teknike dhe finaciare të mjaftueshme për përmbushjen e të dy loteve ju sqarojmë si më poshtë:

Operatori/ët ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të plotësojë në mënyrë kumulative kriterin për kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe teknik. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme."

Nisur nga ky sqarim qe nje operator ekonomik te marri pjese ne te dyja lotet duhet qe plotesoje kriteret per cdo lot Kriteret për kualifikim: 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4.

Nga verifikimet tona OE "Klodjan Vërçani" P.F nuk i ploteson keto kapacitete teknike, dhe ne keto kushte duhej skualifikohej dhe jo te kualifikohet ne te dyja lotet.

Kualifikimi ne te dyja lotet nga ana e autoritetit kontraktor i operatorit ekonomik Klodjan Vërçani eshte i padrejte dhe favorizues pasi nuk ploteson kriteret e vecanta dhe ne keto kushte duhet te skualifikohet.

Arsyeja e kundërshtimit per kualifikimin e padrejte te operatorit ekonomik Klodjan Vërçani lidhet ngushtesisht me diskriminimin e operatoreve te tjere qe kane marre pjese dhe qe jane kualifikuar pasi u hiqet mundesia per efekt favorizimi per te qene fitues kesaj procedure ose ne vecanti te nje loti.

Konkretisht ne Lotin 2 "Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Rajonal Elbasan" me fond limit 3,190,580 (tre milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, kane marre pjese 7 (shtate) operatore ekonomike dhe nga te kualifikuarit ne vend te pare eshte renditur dhe eshte shpallur fitues operatori ekonomik Klodjan Vërçani me oferten ekonomike te paraqitur ne vleren prej 2.288.700,00 leke pa tvsh dhe shoqeria jone RAMA-GRAF shpk eshte renditur ne vend te dyte me oferten ekonomike ne vleren prej 2.586.400,00 leke pa tvsh. Kualifikimi i padrejte i operatorit ekonomik Klodjan Vërçani per kete lot na ka hequr mundesine per te qene fitues i ketij loti.

Persa me siper vendimarrja e autoritetit per kualifikimin e operatorit ekonomik Klodjan Vërçani ne kundërshtim me ligjin, aktet ligjore ne fushen e prokurimeve si dhe ne kundërshtim me vete kriteret qe ka percaktuar per kete procedure dhe me sqarimin qe ka bere ne lidhje me menyren sesi do te plotesoheshin kriteret e kualifikimit eshte ne shkelje te hapur duke ndikuar ne vleresimin e operatoreve te tjere te cilet kane ofertuar dhe ne diskrimin me barazine ne tender.

Persa me siper ne kerkojme anullimin e vendimit te KVO per te dyja lotet, rivleresimin e procedures per te dyja lotet dhe skualifikimin e operatorit ekonomik Klodjan Vërçani per te dyja lotet per mos permbushje te kriterëve te vecanta sipas arsyetimeve ne kete ankese.

III.1.1. Neni 24, pika 1, "Komisioni i prokurimit Publik" i Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike."

Në nenin 111, pika 1, "Paraqitja e ankesës" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik."

Neni 112, pikat 1,2 dhe 3 "Veprimet paraprake" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike

vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

III.1.2. Neni 93, pika 5, “Oferta anomalisht e ulët” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

III.1.3 Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatoi se operatori ekonomik ankimues “RAMA GRAF” ShPK, pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton i skualifikuar përkatësisht për **Lotin 1** me arsyen e skualifikimit:

“Nga përlllogaritja rezultoi se oferta ekonomike me vlerë 2,464,300 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë pa TVSH, paraqitur nga operatori ekonomik “RAMA GRAF” ShPK me Nuis K42701205E është anomalisht e ulët.

Për rrjedhojë dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

Operatori Ekonomik s’kualifikohet.”

Referuar të dhënave mbi procedurën e prokurimit publikuar në SPE, konstatohet se sipas urdhrorit të prokurimit që daton më 27.05.2025, periudhë në të cilën Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ka pësuar ndryshime me Ligjin 16/2024, datë 08.02.2024.

Referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi “Procedura e Hapur e Thjeshtuar”, me objekt: Botime, printime dhe materiale shtypshkrime ndarë në 2 (dy) lote, me fond limit 7,811,323.³³ Lekë pa TVSH

Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeristar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Loti 2. Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Rajonal Elbasan, me Nr. REF-49293-05-28-2025, me fond limit 3,190,580 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara,

rezulton më vlerë të fondit limit nën kufirin e ulët monetar, referuar VKM-së Nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”,

kreu II pika 1 ku përcaktohet se:

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë² ;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Konkretisht ndryshimet në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kanë hyrë në fuqi pas datës 20.03.2024, dhe për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor, në përputhje me nenin 93, pika 5, e LPP-së

(5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.) e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët, pa kërkuar shpjegime.

III.1.4. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Neni 94, pika 1 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkon shprehimisht që ankimuesi jo vetëm të ketë interes të ligjshëm por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit.

Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ankimuesi ka parashtruar pretendime vetëm mbi kualifikimin e

operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi në nenin 110 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” indryshuar, ka parashikuar afate strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë të qartë se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore.

Refruar ankesës operatori ekonomik ankimues “RAMA GRAF” ShPK, ka paraqitur pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Klodjan Vërçani” P.F dhe nuk ka kundërshtuar e argumentuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit **Loti 1** “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeristar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar për skualifikimin e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji.

Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të rregullohet përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.5. Komisioni vëren se i vetmi interes i ligjshëm që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit dhe nuk e ka kundërshtuar këtë fakt, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar brenda afateve ligjore, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues “RAMA GRAF” SHPK nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar, për sa kohë vetë rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi në kuptim të nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “RAMA GRAF” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me objekt: me objekt: Botime, printime dhe materiale shtypshkrime ndarë në 2 (dy) lote, me fond limit 7,811,323.³³ Lekë pa TVSH

Loti 1 “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Spitalin Univeritar të Traumës”, me Nr. REF-49291-05-28-2025, me fond limit 4,620,743.33 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguara nga operatori ekonomik “RAMA GRAF” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

